17. No, I do not want anything else, thank you!
18. Mr. Treska, where is your oldest son? I have not seen him lately.
19. He is sick.
20. **What's** wrong with him?
21. He has a bad case of flu.
22. How is the youngest boy?
23. I have sent him to my parents.
24. The groceries are ready, here you are. Thank you Mr. Treska!



ADJECTIVES.

1. In the previous lesson we studied the Predicate Adjective. They are adjectives which follow the verb to be and they agree with the noun-subject in gender and number. For example:

- a. Djali është i mirë (describing a noun masculine singular)
- b. Vajza është e mirë (describing a noun feminine singular)
- c. Djelmt janë të mirë (describing a noun masculine plural)
- d. Vajzat janë të mira (describing a noun feminine plural)

In each sentence above we have an adjective in four different forms, each different according to what noun it describes. However, for all of them we ask just one type of question:

- a. Qysh është djali?      Djali është i mirë.
- b. Qysh është vajza?      Vajza është e mirë.
- c. Qysh janë djelmt?      Djelmt janë të mirë.
- d. Qysh janë vajzat?      Vajzat janë të mira.

2. Now, look at the following sentences carefully:

- a. Nji djalë i mirë studjon.
- b. Djali i mirë është në klasë.
- c. Disa djelm të mirë studiojnë përditë.
- d. Djelmt e mirë kanë shkue në shtëpi.
- e. Unë kam nji djalë të mirë.

- f. Ai e njef djalin e mirë.
- g. Na kemi dy djelm të mirë.
- h. Ata nuk i njofin djelmt e mirë.

Remark I. In each of the above sentences the adjective (underlined) is not placed after the verb to be. On the contrary, the adjective is placed before the verb, right after the noun. Here, however, the adjective does not describe the noun, but it qualifies it. This type of adjective, when it qualifies the noun, is said to be used "attributively."

Remark II. From sentence a. to h., the adjectives have changed. This is the reason why:

The adjective used attributively agrees with the noun it qualifies not only in number and gender but also in form and case. In other words, the adjective used attributively is declined with the noun it qualifies. The connecting particle is the only part of the adjective that is declined. When an adjective has no connecting particle it is not declined. The cases you know so far are the nominative and the accusative with their four forms - singular indefinite and definite, plural indefinite and definite.

At this point let us see how the connecting particle changes when it is declined with the noun.

When the noun is masculine

INDEFINITE

SINGULAR

PLURAL

nominative: nji djalë i mirë      disa djelm të mirë  
 accusative: nji djalë të mirë      disa djelm të mirë

DEFINITE

nominative: djali i mirë      djelmt e mirë  
 accusative: djalin e mirë      djelmt e mirë



As you can see, e and të (connecting particles) have nothing to do with the gender or the number as you saw in the other type of the adjective, when it was used predicatively.

Other examples:

Singular indefinite

nominative: Nji djalë i mirë shkon në shkollë.  
Nji libër i bukur kushton shumë.  
Ky është një filxhan i bardhë.

accusative: Unë njof një djalë të mirë.  
Ai ka një libër të bukur.  
Unë kam një filxhan të bardhë.

Singular definite

nominative: Djali i mirë shkon në shkollë.  
Libri i bukur kushton shumë.  
Ky është filxhani i bardhë.

accusative: Unë e njof djalin e mirë.  
Ai e ka librin e bukur në xhep.  
Unë pij me filxhanin e bardhë.

Plural indefinite

nominative: Disa djelm të mirë shkojnë në shkollë.  
Disa libra të bukur kushtojnë shumë.  
Këta janë filxhana të bardhë.

accusative: Unë njof disa djelm të mirë.  
Ai ka disa libra të bukur.  
Unë kam disa (dy, tre) filxhana të bardhë.

Plural definite

nominative: Djelmt e mirë shkojnë në shkollë.  
Librat e bukur kushtojnë shumë.  
Këta janë filxhanat e bardhë.

accusative: Unë i njof djelmt e mirë.  
Ai i ka librat e bukur në raft.  
Unë pij me filxhanat e bardhë.

## NOUNS

From the oral drill and vocabulary in this lesson you will notice that many nouns lack a plural and some a singular. It should not be hard to understand this fact since the English language has many of those nouns. For example: sheqer, çaj, gjalp, are substances made up of very small grains; in order to show quantity we have to say: shumë, pak, 5 kilogram sheqer, gjalp, etc.

1. Çfarë sahati është ky?  
Ai është një sahat i shtrëjtë.  
Çfarë rrypi është ky?  
Ai është një rryp i lirë.  
Çfarë uji është ky?  
Ai është ujë i freskët.  
Çfarë djathi është ky?  
Ai është djathë i njomë.  
Çfarë lapsi është ky?  
Ai është një laps i zî.
2. Çfarë sahati keni në xhep?  
Unë kam në xhep një sahat të shtrëjtë.  
Çfarë libri lexoni ju?  
Unë lexoj një libër të bukur.  
Çfarë uji pini ju?  
Unë pij ujë të freskët.  
Çfarë djathi hani?  
Unë ha djathë të njomë.  
Me çfarë lapsi shkrueni?  
Unë shkruaj me laps të zî.
3. Çfarë sahatash janë këta?  
Ata janë sahata të shtrëjtë.  
Çfarë librash janë këta?  
Ata janë libra të lirë.  
Çfarë ullijsh janë këta?  
Ata janë ullij të zez.  
Çfarë djathnash janë këta?  
Ata janë djathna të njomë.  
Çfarë lapsash janë këta?  
Ata janë lapsa të kaltërt.
4. Çfarë sahatash keni ju?  
Unë kam sahata të shtrëjtë.  
Çfarë librash lexoni ju?  
Unë lexoj libra të bukur.  
Çfarë ullijsh hani ju?  
Unë ha ullij të zez.  
Çfarë djathnash hani ju?  
Unë ha djathna të njomë.  
Me çfarë lapsash shkrueni?  
Unë shkruaj me lapsa të kaltërt.

5. Ku është sahati i shtrëjtë?  
 Sahati i shtrëjtë është në xhep.  
 Ku është libri i lirë?  
 Libri i lirë është në raft.  
 Ku është uji i freskët?  
 Uji i freskët është në shishe.  
 Qysh është djathi i njomë?  
 Djathi i njomë është shumë i mirë.  
 Ku është lapsi i zî?  
 Lapsi i zî është në tryezë.
6. Ku e keni sahatin e shtrëjtë?  
 Unë e kam sahatin e shtrëjtë në xhep.  
 Ku e keni librin e bukur?  
 Unë e kam librin e bukur në shtëpi.  
 Ku e mbani djathin e njomë?  
 Unë e mbaj djathin e njomë në pjatë.  
**Me cilin laps shkrueni?**  
 Unë shkruaj me lapsin e zî.
7. Ku janë sahatat e shtrëjtë?  
 Sahatat e shtrëjtë janë në xhep.  
 Ku janë librat e lirë?  
 Librat e lirë janë në raft.  
 Ku janë ullijt e zez?  
 Ullijt e zez janë në pjatë.  
 Ku janë djelmt e sëmundë?  
 Djelmt e sëmundë janë në shtëpi.
8. Ku i keni sahatat e shtrëjtë?  
 Unë i kam sahatat e shtrëjtë në xhep.  
 Ku i keni librat e bukur?  
 Unë i kam librat e bukur në raft.  
 Ku i mbani ullijt e zez?  
 Unë i mbaj ullijt e zez në raft.  
 Me cilët lapsa shkrueni?  
 Unë shkruaj me lapsat e zez.
9. Çka keni?  
 Jam i sëmundë.  
 Çka ka Zotni Kapteri?  
 Edhe Zotni Kapteri është i sëmundë.  
 Çka kanë nxânsit?  
 Nxânsit janë të sëmundë; ata kanë grip.  
 Çka ka mësuesi?  
 Edhe mësuesi ka grip.

10. Zotní \_\_\_\_\_.  
 Urdhënoni!  
 A keni një pëndë, ju lutem?  
 Si urdhënoni, Zotní Mësues.  
 Zotní Treska!  
 Urdhënoni, Zotní!  
 Kërkoni gjellën, ju lutem!  
 Si urdhënoni, Zotní.  
 A keni një cingare?  
 Si urdhënoni, kam. Urdhënoni një cingare!  
 A dini me folë shqip?  
 Si urdhënoni, Zotní.  
 A dini me folë anglisht?  
 Si urdhënoni, Zotní.  
 Tungjatjeta! Urdhënoni, Zotní!
11. Çka dishroni, Zotní?  
 Unë dishroj me blé një kg. djathë të njomë.  
 Çka dishron shoku juej?  
 Shoku im dishron me blé ullij të zez.  
 Çka tjetër dishroni me blé ju dhe shoku juej?  
 Unë dhe shoku im dishrojmë me blé: sheqer, çaj, kafe  
 e makarona.  
 Çka dishrojnë ushtarët me blé?  
 Ushtarët dishrojnë me blé dy shishe venë.
12. A dërgoni letra në shtëpi?  
 Po, unë dërgoj letra në shtëpi.  
 A dërgon Zotní Kapitëni paqeta në shtëpi?  
 Po, Zotní Kapitëni dërgon paqeta në shtëpi.  
 A dërgoni ju dhe shoku juej paqeta në shtëpi për  
 Krishtlindje?  
 Po, unë dhe shoku im dërgojmë paqeta në shtëpi për  
 Krishtlindje.  
 Po, shokët tjerë, a dërgojnë paqeta në shtëpi për  
 Krishtlindje?  
 Po, edhe shokët tjerë dërgojnë paqeta në shtëpi për  
 Krishtlindje.

Zotni Treska është punëtuer në një fabrikë të vogël në Tiranë; është i martuem dhe ka dy djelm, që i quejnë Fatmir dhe Petrit. Zotni Treska e ka dërgue djalin e vogël, Petritin, ke prindët e tij sepse Fatmiri është i sëmundë me grip.

Zakonisht, harxhin e shtëpis e blën Zoja Treska, por mbasi Fatmiri është në shtëpi vetëm, i sëmundë, Zotni Treska shkon në qytet me blé harxh. Ai blën së pari një gjymës kilogrami gjalp të freskët dhe një kilogram djathë të njomë. Mandej merr një ulli të zî, e kërkon dhe mbasi janë të mirë, blën dyqind gram ullij. Kur Zotni Treska dhe zoja e tij hanë drekë dishrojnë me pasë edhe ca ullij me hangër.

## QUESTIONS - PYETJE

1. Çka punon Zotni Treska?
2. Ku punon Zotni Treska?
3. Ku është kjo fabrikë e vogël?
4. Kush është i martuem?
5. Sa fëmijë ka?
6. Si i quejnë djelmt?
7. Cili është djali i madh?
8. Ku e ka dërgue Petritin Zotni Treska?
9. Kë ka dërgue Zotni Treska ke prindët e tij?
10. Pse e ka dërgue Zotni Treska Petritin ke prindët e tij?
11. Çka ka Fatmiri?
12. Kush e blën harxhin e shtëpis, zakonisht?
13. Çka blën Zoja Treska, zakonisht?
14. Kush është në shtëpi vetëm, i sëmundë?
15. Pse shkon Zotni Treska në qytet me blë harxh?
16. Çka blën ai së pari?
17. Sa gjalp të freskët dhe sa djathë të njomë blën ai?
18. Çfarë gjalpi dhe çfarë djathi blën Zotni Treska?
19. Çfarë ullini merr ai mandej?
20. Çka bân ai me ullinin e zi?
21. Qysh janë ullijt e zez?
22. Sa gram ullij të zez blën?
23. Cilët dishrojnë me pasë edhe ca ullij kur hanë drekë?
24. Kur hanë ullij Zotni Treska dhe zoja e tij?

Translate the following sentences into Albanian:

1. There are green and black olives.
2. The green olives are small, the black olives are large.
3. I have two brothers but only one is married. The married brother has two beautiful children.
4. On the yellow table are three blue books.
5. Do you often eat bread with fresh butter?
6. Have a cigarette!
7. Yes, Sir! It is correct.
8. How do I read?



PJESA E SHTATË  
FJALORI

LESSON 24  
PART VII  
VOCABULARY

me blé (unë bléj)	(v.)	to buy, to purchase
çaj, -i	(m.)	tea
me dërgue (unë dërgoj)	(v.)	to send
me dishrue (unë dishroj)	(v.)	to desire, to wish
djathë, -i	(m.)	cheese
dyqind	(adj.)	two hundred
m'epni!	(v.)	give me!
<b>i, e, të freskët</b> <b>të freskëta</b>	(adj.m.&f.)	fresh, cool
gram, -i gram, -t	(m.)	gram (1/1000 of a kilo- gram; 1 ounce equal to 28 grams)
grip, -i	(m.)	influenza (flu)
gjalp, -i	(m.)	butter
harxh, -i harxhe, -t	(m.)	groceries, provisions, food, expense, outlay
me kërkue (unë kërkuj)	(v.)	to ask for, to demand, to request, to look for, to seek for, to search for, to require (for); to taste
kilogram, -i kilogram, -t	(m.)	kilogram (equal to 2.2 pounds)
makarona, -t	(f.pl.)	macaroni, spaghetti
<b>i, e, të njomë</b> <b>të njoma</b>	(adj.m.&f.)	fresh, moist, damp, young, soft

i, e, të rëndë të rënda	(adj.m.&f.) heavy, serious, severe, hard
rëndësi, -ja	(f.) importance
i, e, të sëmundë të sëmunda	(adj.m.&f.) sick, ill
si	(adv.) how
sheqer, -i	(m.) sugar
i, e, të shtrëjtë të shtrëjta	(adj.m.&f.) expensive, dear
ullî, -ni ullîj, -t	(m.) olive (fruit and tree)
i zî, e zezë të zez, të zeza	(adj.m.&f.) black

---

**NOTES:**

Ç'urdhënoni?	What would you like to have? May I help you?
Si urdhënoni!	Yes, sir! (after an order or in agreement)
Qenka i shtrëjtë djathi!	Why! The cheese is expensive!
S'ka rëndësi	It is not important, does not matter, never mind.
Ku e keni.....?	Where is your .....?
Çka ka?	What is the matter with him? What is wrong with him?
këto ditë	recently

1. A shkon një vajzë e mirë në shkollë përditë?  
Po, një vajzë e mirë shkon në shkollë përditë.  
A banon një mësuese e gjatë në Monterej?  
Po, një mësuese e gjatë banon në Monterej?  
A banon një vajzë e fejueme në qytet?  
Po, një vajzë e fejueme banon në qytet.  
Ku ha një mësuese durrsake?  
Një mësuese durrsake ha në mensë.
2. Sa kushton shtëpia e bardhë?  
Shtëpia e bardhë kushton shumë.  
Sa kushton goma e kuqe?  
Goma e kuqe kushton pak.  
Sa kushton brusha e zezë?  
Edhe brusha e zezë kushton pak.  
Sa ditë në javë shkon në shkollë vajza e bukur?  
Vajza e bukur shkon në shkollë pesë ditë në javë.  
Ku banon mësuesja durrsake?  
Mësuesja durrsake banon në qytet.
3. A shifni një grue të bukur në pikturë?  
Po, në pikturë shof një grue të bukur.  
A shifni një vajzë të gjatë në rrugë?  
Po, unë shof një vajzë të gjatë në rrugë.  
A njifni një nësuese të martueme?  
Po, unë njof një mësuese të martueme.  
A shifni një vajzë durrsake përditë?  
Po, unë shof një vajzë durrsake përditë.  
A njifni një grue shqiptare?  
Po, unë njof një grue shqiptare.
4. A e shifni gomën e kuqe?  
Po, unë e shof gomën e kuqe.  
A e shifni mësuesen e gjatë përditë?  
Po, unë e shof mësuesen e gjatë përditë.  
A e shifni shtëpinë e bardhë?  
Po, unë e shof shtëpinë e bardhë.  
A e shifni kutin e zezë?  
Po, unë e shof kutin e zezë.  
A e njifni nxânsen durrsake?  
Po, unë e njof nxânsen durrsake.


- A e njifni mësuesen shqiptare?  
Po, unë e njof mësuesen shqiptare.
5. A shkojnë disa vajza të mira në shkollë përditë?  
Po, disa vajza të mira shkojnë në shkollë përditë.  
A banojnë disa mësuese të bukura në Monterey?  
Po, disa mësuese të bukura banojnë në Monterey.  
A nxënë anglisht disa vajza durrsake?  
Po, disa vajza durrsake nxënë anglisht.  
A flasin anglisht disa grá shqiptare?  
Po, disa grá shqiptare flasin anglisht.  
A punojnë në qytet disa vajza të fejueme?  
Po, disa vajza të fejueme punojnë në qytet.  
A punojnë në zyrë disa grá të martueme?  
Po, disa grá të martueme punojnë në zyrë.
6. A shkojnë vajzat e mira në shkollë përditë?  
Po, vajzat e mira shkojnë në shkollë përditë.  
A banojnë vajzat e fejueme në qytet?  
Po, vajzat e fejueme banojnë në qytet.  
A hanë grát e martueme në mensë?  
Po, grát e martueme hanë në mensë.  
A kushtojnë shumë gomat e kuqe?  
Jo, gomat e kuqe nuk kushtojnë shumë.  
Sa kushtojnë franxhollat e nxehta?  
Franxhollat e nxehta kushtojnë nga dhetë lekë.
7. A shifni disa vajza të mira përditë?  
Po, unë shof disa vajza të mira përditë.  
A shifni disa mësuese të bukura?  
Po, unë shof disa mësuese të bukura.  
A njifni disa vajza të fejueme?  
Po, unë njof disa vajza të fejueme.  
A shifni disa vajza durrsake përditë?  
Po, unë shof disa vajza durrsake përditë.  
A njifni disa mësuese shqiptare?  
Po, unë njof disa mësuese shqiptare.  
A shifni disa goma të kuqe mbi tryezë?  
Po, unë shof disa goma të kuqe mbi tryezë.  
A shifni disa brusha të zeza në pikturë?  
Po, unë shof disa brusha të zeza në pikturë.  
A shifni disa shtëpí të bardha në qytet?  
Po, unë shof disa shtëpí të bardha në qytet.
8. A i njifni vajzat e bukura?  
Po, unë i njof vajzat e bukura.  
A i shifni shtëpít e bardha?  
Po, unë i shof shtëpít e bardha.

A i njifni nxânsset durrsake?  
Po, unë i njof nxânsset durrsake.  
A i shifni vajzat e fejueme përditë?  
Po, unë i shof vajzat e fejueme përditë.  
Ku i bleni gomat e kuqe?  
Unë i blëj gomat e kuqe në dyqan.  
Po gozhdat e gjata, ku i bleni?  
Edhe gozhdat e gjata i blëj në dyqan.  
Ku i mbani pëndat e zeza?  
Unë i mbaj pëndat e zeza në syzë.  
Ku i mbani paqetat e mëdhaja?  
Unë i mbaj paqetat e mëdhaja në dhomë.

1. Due me marrë me qirá nji shtëpi tjetër.
2. Me sa dhoma e doni?
3. Me trí dhoma fjetje, kuzhinë, banjë dhe dhomë pritje.
4. Pse kaq shumë dhoma fjetje?
5. Prindët e grues duen me ardhë në Kaliforní me ndejtë ca kohë.
6. E kuptoj; zoja do nji dhomë fjetje për ta.
7. A njifni ndokënd që ep shtëpi me qirá?
8. Po, njof nji njerí që ka nji shtëpi të mirë me trí dhoma fjetje.
9. A është e mobilueme?
10. Po, por nuk ka shumë mobilje.
11. Sa mobilje ka?
12. Dy shtretën, nji sofa, dy kolltukë, stufë e frigorifer.
13. Na duem edhe tre shtretën tjerë.
14. Ju ap unë nji shtrat të gjânë dhe dy të ngushtë, në goftë se doni.
15. Për sa kohë m'i epni?
16. Për nja tre a katër muej.
17. Shumë mirë, ju falem nderës. A ka mundësi me e pá këtë shtëpi?
18. Sigurisht! A doni me ardhë me mue tash?
19. Po. Tash vjen grueja dhe shkojmë të tre.
20. Mirë. Kur vijnë fëmijët nga shkolla?
21. Kur vijnë na në shtëpi nga puna, vijnë edhe ata.
22. Në ç'orë vini ju?
23. Unë vîj n'orën pesë; grueja vjen dhetë minuta më vonë.
24. Kishem me dashë me pasë edhe unë nji orár të tillë!

Idiomatic Translation - Përkëthim i lirë

1. I want to rent another house.
2. How many rooms do you want?
3. I want three bedrooms, kitchen, bathroom and living room.
4. Why so many bedrooms?
5. My wife's parents want to come and spend some time in California.
6. I understand. Your wife wants a bedroom for them.
7. Do you know anybody that rents houses?
8. Yes, I know somebody who has a good house with three bedrooms.
9. Is it furnished?
10. Yes, but it does not have too much furniture.
11. What furniture does it have?
12. It has two beds, a couch, two easy chairs, a stove and a refrigerator.
13. We need three more beds.
14. If you want I will give you a double bed and two single beds.
15. How long may we keep them?
16. Three or four months.
17. Very well, thank you! Is it possible to see this house?
18. Certainly! Do you want to go with me now?
19. Yes! My wife will come now and we will go together.
20. Fine! When do the children come from school?
21. They come home the same time we come from work.
22. At what time do you come home?
23. I come at five o'clock and my wife comes ten minutes later.
24. I wish I had such a time schedule!





ADJECTIVES

In declining feminine adjectives, the connecting particle is only different in the nominative singular. For example:

When the noun is masculine

When the noun is feminine

Indefinite Singular

nominative:

Nji djalë i mirë studjon.

Nji vajzë e mirë studjon.

accusative:

Unë njof nji djalë të mirë.

Unë njof nji vajzë të mirë.

Indefinite Plural

nominative:

Disa djelm të mirë studjojnë.

Disa vajza të mira studjojnë.

accusative:

Unë njof disa djelm të mirë.

Unë njof disa vajza të mira.

Definite Singular

nominative:

Djali i mirë studjon.

Vajza e mirë studjon.

accusative:

Unë e njof djalin e mirë.

Unë e njof vajzën e mirë.

Definite Plural

nominative:

Djelmt e mirë studjojnë.

Vajzat e mira studjojnë.

accusative:

Unë i njof djelmt e mirë.

Unë i njof vajzat e mira.

THE PREPOSITION NGA

In Lesson 3 you had the preposition nga which means each, from, to, towards, about, by. So far you know

the usage of two of these meanings, that is:

1. Each, for each, apiece. For example:

Ata kanë nga një libër (They each have a book; every one of them has a book.)

Na kemi nga dy dhoma (We each have two rooms; there are two rooms for each of us.)

Ata shkruen nga një letër (They each wrote a letter.)

2. Origin, from. For example:

Jam nga Shqipëria (I am from Albania.)

Ai është nga Durrësi (He is from Durrës; he is a native of Durrës.)

Now let us see the other meanings of the preposition "nga":

3. Point of departure for distance or time, from. For example:

Nga shkolla deri në qytet rruga është e mirë. (The road is good from the school to the city.)

Nga një tryezë deri në një tjetër janë dy metra. (It is two meters from one desk to the other.)

Ai flet nga mëngjesi deri në mbrëmje. (He speaks from morning to evening.)

Unë studioj nga ora 6 deri në 7. (I study from six o'clock till seven.)

4. Direction: from or to, depending on the verb. For example:

From  
Nga vîni?  
(Where do you come from?)

To  
Nga shkoni?  
(Where do you go?)

Treni vjen nga qyteti.  
(The train comes from the city.)

Treni shkon nga qyteti.  
(The train goes to the city.)

5. Towards. For example:

Ai vjen nga mbrâmja. (He comes towards(the)evening.)

Kam shum të ftofët nga mëngjesi. (I am cold towards morning.)

6. By. For example:

Nji nga nji ose dy nga dy. (One by one or two by two.)

7. About. For example:

Ai âsht nga shkon. (He is about to go, is ready to go,  
almost going).

Remark. Nga is a preposition which governs the nominative case when it has the meaning mentioned in 2, 3, 4, and 5.  
Example:

nga	(nji shkollë (shkolla (disa shkolla (shkollat	from	(a school (the school (some schools (the schools
nga	(nji qytet (qyteti (disa qytete (qytetet	from	(a city (the city (some cities (the cities

1. Kur vîj unë në shkollë?  
Ju vîni në shkollë në mëngjes.  
Kur vîni ju në shkollë?  
Edhe unë vîj në shkollë në mëngjes.  
Në ç'orë vjen mësuesi në shkollë në mëngjes?  
Mësuesi vjen në shkollë n'orën tetë në mëngjes.  
Në ç'orë vîni ju dhe shoku juej në shkollë mbasdreke?  
Unë dhe shoku im vîjmë në shkollë n'orën një mbasdreke.  
Kur vîjnë shokët tjerë në shkollë mbasdreke?  
Edhe shokët tjerë vîjnë në shkollë n'orën një mbasdreke.
2. Ku doni me marrë shtëpi me qirâ?  
Unë due me marrë shtëpi me qirâ në Monterej.  
Për sa kohë doni me marrë shtëpi me qirâ?  
Due me marrë shtëpi me qirâ për gjashtë muej.  
Me sa dhoma e doni shtëpin?  
Unë e due shtëpin me gjashtë dhoma.  
A doni me marrë me qirâ shtëpi të mobilueme?  
Po, unë due me marrë me qirâ shtëpi të mobilueme.  
A e dini kush ka shtëpi me dhânë me qirâ?  
Jo, nuk e di kush ka shtëpi me dhânë me qirâ.  
A e dini kush ka automobil me dhânë me qirâ?  
Jo, nuk e di kush ka automobil me dhânë me qirâ.  
A e dini kush ka një barkë me dhânë me qirâ?  
Jo, nuk e di kush ka një barkë me dhânë me qirâ.
3. A keni një shtëpi të mirë me dhânë me qirâ?  
Jo, unë nuk kam një shtëpi të mirë me dhânë me qirâ.  
Kush ka shtëpi të mira me dhânë me qirâ?  
Nuk e di kush ka shtëpi të mira me dhânë me qirâ.  
A keni një barkë të madhe me dhânë me qirâ?  
Jo, unë nuk kam një barkë të madhe me dhânë me qirâ.  
Kush ka barka të mëdhaja me dhânë me qirâ?  
Unë nuk e di kush ka barka të mëdhaja me dhânë me qirâ.  
Kush ep automobila me qirâ?  
Unë ap automobila me qirâ.  
Kush merr barka me qirâ?  
Unë marr barka me qirâ.
4. Sa dhoma fjetje doni?  
Unë due dy dhoma fjetje.  
Sa dhoma pritje doni?  
Unë due një dhomë pritje.  
Çfarë mobiljesh do zoja juej?  
Zoja ime do mobilje të mira.

Çfarë kuzhine do zoja juej?  
 Zoja ime do një kuzhinë të bukur dhe të madhe.  
 Çfarë shtëpije duen fëmijët tuej?  
 Fëmijët e mij duen një shtëpi të madhe.  
 Çka tjetër doni ju dhe zoja juej?  
 Na duem tre shtretën, një stufë dhe një frigorifer.

5. A e doni vllan?  
 Po, unë e due vllan.  
 A e doni shokun?  
 Po, unë e due shokun.  
 A e doni hallën?  
 Po, unë e due hallën.  
 A i doni vllaznit?  
 Po, unë i due vllaznit.  
 A i doni prindët?  
 Po, unë i due prindët.  
 A e do nëna djalin?  
 Po, nëna e do djalin.  
 A e do nëna vajzën?  
 Po, nëna e do vajzën.  
 A i do nëna fëmijët?  
 Po, nëna i do fëmijët.  
 A i do nëna djelmt?  
 Po, nëna i do djelmt.  
 A i do nëna vajzat?  
 Po, nëna i do vajzat.
6. Sa kohë doni me ndejtë në Monterej?  
 Due me ndejtë një pesë a gjashtë muaj në Monterej.  
 Sa kohë doni me ndejtë në Shqipni?  
 Due me ndejtë një dy a tre muaj në Shqipni.  
 Për sa kohë e doni automobilin?  
 Unë e due automobilin për dy muaj.  
 Për sa kohë e doni dhomën?  
 Unë e due dhomën për gjashtë muaj.  
 Për sa kohë e doni fjalorin?  
 Unë e due fjalorin për njëmuajtë muaj.  
 A ka mundësi me marrë një dhomë me qirë në Presidio?  
 Jo, s'ka mundësi me marrë një dhomë me qirë në Presidio.  
 A ka mundësi me hangër në mensë?  
 Po, ka mundësi me hangër në mensë.  
 A ka mundësi me blë libra në Presidio?  
 Po, ka mundësi me blë libra në Presidio.

7. Prej nga jeni?  
Unë jam nga Nju Jorku.  
Nga sa libra keni ju?  
Na kemi nga një libër.  
Nga sa letra shkruajnë nxënësit?  
Nxënësit shkruajnë nga dy letra.  
Nga sa pënda blejnë nxënësit?  
Nxënësit blejnë nga një pëndë.

Zotni Zerqani do me marrë me qirá nji shtëpi me trí dhoma fjetje. Shtëpija që ka tash ka vetëm dy dhoma fjetje, dhomë pritje, kuzhinë dhe banjë.

Zotni Zerqani do nji shtëpi më të madhe sepse prindët e Zojës Zerqani duen me ardhë në Kaliforni me ndejtë ca kohë.

Zotni Skrapari njef nji njeri që ka nji shtëpi me trí dhoma fjetje me dhânë me qirá. Kjo shtëpi nuk ka shumë mobilje; ka vetëm stufë, frigorifer, dy shtretën, nji sofa dhe dy kolltukë. Zotni Zerqani do pesë shtretën; Zotni Skrapari ka tre shtretën për Zotni Zerqanin. Zotni Zerqani me zojën dhe Zotni Skraparin shkojnë me e pá shtëpin n'orën pesë.

Fëmijët e Zotni Zerqanit vijnë në shtëpi nga shkolla n'orën katër.

Në bibliotekë apim libra e revista me lexue; na në departament apim vetëm gazeta shqipe.

## QUESTIONS - PYETJE

1. Kush do me marrë një shtëpi me qirë?
2. Çka do me bë Zotni Zerqani?
3. Me sa dhoma e do shtëpinë Zotni Zerqani?
4. Sa dhoma ka shtëpia që ka tash?
5. Sa dhoma tjera ka shtëpia që ka tash?
6. Pse do një shtëpi më të madhe Zotni Zerqani?
7. Prindët e kujt duen me ardhë në Kaliforni?
8. Pse duen me ardhë në Kaliforni prindët e Zojës Zerqani?
9. Sa kohë duen me ndejtë ata në Kaliforni?
10. Kush një një njeri që ka një shtëpi me tri dhoma?
11. Kë një Zotni Skrapari?
12. Cila shtëpi nuk ka shumë mobilje?
13. Kush do pesë shtretën?
14. Sa shtretën do Zotni Zerqani?
15. Kush ka tre shtretën për Zotni Zerqanin?
16. Për kë ka Zotni Skrapari tre shtretën?
17. Me kë shkon Zotni Zerqani me e pa shtëpinë?
18. Çka bëjnë Zotni Zerqani me zojën dhe me Zotni Skraparin?
19. Në ç'orë shkojnë me e pa shtëpinë ata?
20. Kush vjen në shtëpi nga shkolla në orën katër?
21. Në ç'orë vijnë fëmijët e Zotni Zerqanit në shtëpi?
22. Ku apin libra e revista me lexue?
23. Çka apin në bibliotekë?
24. Çka apin na në departament me lexue?
25. Ku apin revista shqipe me lexue.



Answer the following questions by using the adjectives in parentheses as cues:

1. Si është uji që pini ju? (fresh)
2. Çfarë uji pini ju, zakonisht? (fresh)
3. Si është shtrati juaj? (wide)
4. Çfarë shtrati keni ju? (wide)
5. Çfarë shtëpije keni marrë me qirâ? (furnished)
6. Në çfarë shtëpije banoni? (furnished)
7. Si janë dhomat? (large)
8. Cilat dhoma janë të bukura? (large)
9. Cilët djelm shkojnë në shkollë? (good)
10. Cilat vajza studiojnë shumë? (good)

PJESA E SHTATË  
FJALORI

LESSON 25  
PART VII  
VOCABULARY

me ardhë (unë vîj)	(v.)	to come
me dashë (unë due)	(v.)	to want, to like, to love
me dhânë (unë ap)	(v.)	to give
me dhânë me qirá (unë ap me qirá)	(v.)	to rent (give on rent), to hire out
dhomë fjetje	(f.)	bedroom
dhomë pritje	(f.)	living room
frigorifer, -i frigoriferë, -t	(m.)	refrigerator
i, e, të gjânë të gjâna	(adj.m.&f.)	wide, broad
kaq	(adv.&adj.)	so many; so much; that's all
kolltuk, -u kolltukë, -t	(m.)	easy chair
kuzhinë, -a kuzhina, -t	(f.)	kitchen
me marrë me qirá (unë marr me qirá)	(v.)	to rent (receive on rent), to hire
mobilje, mobilja mobilje, -t	(f.)	furniture
i, të mobiluem e, të mobilueme	(adj.m.&t.)	furnished (with furniture)
mundësi, -ja mundësi, -t	(f.)	possibility
me ndejtë (unë rrij)	(v.)	to stay, to sit
nja	(adv.)	about, approximately

LESSON 25

orár, -i orarë, -t	(m.)	schedule, timetable
qirá, -ja qirá, -t	(f.)	rent
sigurisht	(adv.)	certainly, surely
sofa, -ja sofa, -t	(f.)	sofa
stufë, -a stufa, -t	(f.)	stove, heater
shtrat, -i shtretën, shtretnit	(m.)	bed
ta	(pron.)	them (diminutive of <u>ata</u> , them)
i, e, të tillë të tilla	(adj.m.&f.)	such, of this sort
të tre, të trija	(adj.m.&f.)	all three

---

NOTES:

për sa kohë?

how long?

kishem me dashë...

I would like to ....

a ka mundësi?

is there any possibility?


1. A shkoni ju në qytet me blé harxh?  
Po, unë shkoj në qytet me blé harxh.  
Çka bleni?  
Unë blëj bukë, pemë, kafe, sheqer, etj.  
Ku i blën Zotni Kapteri cingaret?  
Zotni Kapteri i blën cingaret në PX.  
A blejmë na cingare çdo javë?  
Po, na blejmë cingare çdo javë.  
Ku i blëj unë cingaret?  
Ju i bleni cingaret në qytet.  
Ku i blejnë cingaret ushtarët?  
Ushtarët i blejnë cingaret në PX.
2. Kush e hap derën në mëngjes?  
Mësuesi e hap derën në mëngjes.  
Kush e mbyll derën mbasdreke?  
Nxânsit e mbyllin derën mbasdreke.  
A i mbyllni dyert dhe dritoret mbasdreke?  
Po, na i mbyllim dyert e dritoret mbasdreke.  
A i hapni dyert dhe dritoret në mëngjes?  
Po, na i hapim dyert dhe dritoret në mëngjes.  
A e hap unë librin kur hÿj në klasë?  
Po, ju e hapni librin kur hÿni klasë.  
Po ju, a e hapni librin kur hÿni në klasë?  
Po, unë e hap librin kur hÿj në klasë.  
Po shoku juej, a e hap librin kur hÿn në klasë?  
Po, edhe shoku im e hap librin kur hÿn në klasë.  
Çka bëni ju dhe shoku juej kur hÿni në klasë?  
Unë dhe shoku im hapim librat kur hÿjmë në klasë.  
Po nxânsit tjerë, çka bëjnë kur hÿjnë në klasë?  
Edhe nxânsit tjerë i hapin librat kur hÿjnë në klasë.
3. A ju pëlqen me ndejtë në shtëpi të dielen?  
Po, mue më pëlqen me ndejtë në shtëpi të dielen.  
Pse rrini në shtëpi të dielen?  
Unë rrij në shtëpi me studjue.  
Po unë, a rrij në shtëpi me studjue?  
Jo, ju rrini në shtëpi me lexue.  
Ku rrijmë na kur kemi dhetë minuta pushim?  
Na rrijmë në klasë kur kemi dhetë minuta pushim.  
Ku rrijnë mësuesit kur nuk janë në klasë?  
Mësuesit rrijnë në zyrë kur nuk janë në klasë.

4. Në ç'orë shkoni me fjetë?  
Unë shkoj me fjetë n'orën tetë e gjymës.  
Në ç'orë flëj unë?  
Nuk e di në ç'orë flëni ju.  
Në ç'orë flën zoja?  
Zoja flën n'orën tetë.  
Në ç'orë flëni ju dhe zoja të shtunden?  
Të shtunden unë dhe zoja flëjmë n'orën 10.  
Në ç'orë flëjnë fëmijët?  
Fëmijët flëjnë n'orën shtatë e gjymës.

1. Si është e mundur që automobili juej është gjithëmonë i pastër?
2. Jo gjithëmonë. Nganjihërë është i ndytë, sidomos mbrendë.
3. A e lani shpesh?
4. E lãj çdo të shtunde me ujë e sapun.
5. Kush e lãn, ju apor zoja?
6. Zakonisht e lãj unë; nganjihërë e lajmë bashkë.
7. Çë model është?
8. Asht Ford 1977
9. Të rí e keni blë?
10. Jo, e kam blë sivjet, natyrisht të përdorun.
11. Si shkon motori?
12. Motori nuk është i keq, por automobili ka nevojë për goma.
13. Kush e përdor mã shumë automobilin, ju apor zoja?
14. Natyrisht unë; ajo rri në shtëpi.
15. A shkoni ndokund mbasdarke, apor rrini në shtëpi?
16. Zakonisht rrijmë në shtëpi; nganjihërë shkojmë në kinema.
17. Si duket ju pëlqen me ndejtë në shtëpi.
18. Jo, nuk më pëlqen aspak, por rrij me nxânë dialogun përmendsh.
19. Vetëm dialogun?
20. Jo, studjoj mësimin, pyetjet dhe ushtrimet tjera.
21. Të lumtë, shumë i zellshëm! Me kë rrijnë fëmijët kur shkoni në kinema?
22. Rrijnë me një vajzë që marrim me pagesë.
23. A nuk qajnë?
24. Jo, nuk qajnë, sepse e njofin.

Idiomatic Translation - Përkëthim i lirë

1. How is it possible that your car is always clean?
2. Not always. Sometimes it is dirty, especially inside.
3. Do you wash it often?
4. I wash it every Saturday with soap and water.
5. Who washes it, you or your wife?
6. Usually I wash it, sometimes my wife and I wash it together.
7. What model is it?
8. It is a 1977 Ford.
9. Did you buy it new?
10. No, I bought it this year, used, of course.
11. How does the motor run?
12. The motor isn't bad but the car needs tires.
13. Who uses the car the most, you or your wife?
14. Naturally I use it more, my wife stays home.
15. Do you go anywhere after dinner, or do you stay home?
16. Usually we stay home, once in a while we go to the movies.
17. It seems you like to stay home.
18. No, I do not like to stay home at all, but I have to in order to memorize the daily dialogue.
19. Only the dialogue?
20. No, I also study the lesson, the questions and the other exercises.
21. **Bravo! You are very zealous! With whom do you leave the children when you go to the movies?**
22. They stay with a baby-sitter.
23. Don't they cry?
24. No, they don't, because they know her.





### ADVERBS

The adverb *ndokund*, meaning anywhere, somewhere, is always used in interrogative sentences. For example:

- A shkoni *ndokund* në mbrâmje? Do you go anywhere in the evening?  
A ka *ndokund* këtu ujë me pî? Is there drinking water somewhere around?  
A kanë ata shtëpí *ndokund* në Kaliforní? Do they own a house anywhere in California?

For sentences other than interrogative there are, in Albanian, other adverbs meaning somewhere, anywhere. We will introduce them later.

### ADJECTIVES

In the vocabulary of this lesson there is an adjective (*e mundun* -"possible" which has only the feminine form. The adjective does exist in four normal forms: *i*, *e*, *të mundun*, *të munduna*, but the masculine does not have the meaning of *possible*, but rather, defeated. The feminine form *e mundun* is a short form of *nji gjâ e mundun* "a possible thing;" *Gjâ* is a feminine noun and the adjective agrees with it; *nji gjâ* is dropped and what remains is the idiomatic expression *e mundun* "possible." Many of these adjectives are used only in the feminine form.

### DECLENSION

The main feature of these 10 lessons has been the declension of nouns and adjectives, in other words the inflection and changes of nouns and adjectives while they have different functions. We have seen so far two of these functions: the subject case (or nominative) and the direct object (or accusative). As we go along, we shall present other functions, but for now we are summarizing the declension of a noun with an adjective in two synoptic tables. You may complete these tables by filling in the missing cases as they are introduced to you.

Declension of a masculine noun with an adjective

M A S C U L I N E			
I N D E F I N I T E		D E F I N I T E	
S I N G U L A R	P L U R A L	S I N G U L A R	P L U R A L
nom. (nji) oficer i mirë	(disa) oficera të mirë	oficeri i mirë	oficerat e mirë
gen.			
dat.			
acc. (nji) oficer të mirë	(disa) oficera të mirë	oficerin e mirë (1)	oficerat e mirë (2)
abl.			

- (1) Case in which the pronoun direct object e may go directly before the verb.  
 (2) Case in which the pronoun direct object i may go directly before the verb.

Declension of a feminine noun with an adjective

F E M I N I N E			
I N D E F I N I T E		D E F I N I T E	
S I N G U L A R		P L U R A L	
	S I N G U L A R	P L U R A L	S I N G U L A R P L U R A L
nom.	(nji) vajzë e mirë	(disa) vajza të mira	vajza e mirë vajzat e mira
gen.			
dat.			
acc.	(nji) vajzë të mirë	(disa) vajza të mira	vajzën e mirë vajzat e mira
abl.			(1) (2)

- (1) Case in which the pronoun direct object e may go directly before the verb.  
 (2) Case in which the pronoun direct object i may go directly before the verb.

1. Kush e lán automobilin tuej?  
Unë e láj automobilin tim.  
A e lán shoku automobilin e tij?  
Po, shoku e lán automobilin e tij.  
Kush i lán automobilat tuej?  
Na i lajmë automobilat tonë.  
Çka lajnë nxânsit?  
Nxânsit lajnë automobilat e tyne.
2. A qáj unë shpesh?  
Jo, ju nuk qani shpesh.  
A qán djali i vogël shpesh?  
Po, djali i vogël qán shpesh.  
A qani shpesh ju dhe shoku juej?  
Jo, na nuk qajmë kurr.  
A qajnë fëmijët e vogjël shpesh?  
Po, fëmijët e vogjël qajnë shpesh.
3. A e përdorni fjalorin përditë?  
Po, unë e përdor fjalorin përditë.  
A e përdor shoku pëndën përditë?  
Po, shoku e përdor pëndën përditë.  
A e përdorni ju dhe shoku juej fjalorin shqip përditë?  
Po, unë dhe shoku im e përdorim fjalorin shqip përditë.  
A i përdorin nxânsit librat shqip?  
Po, nxânsit i përdorin librat shqip.
4. A e lani automobilin me ujë të nxehët, apo me ujë të ftofët?  
Unë e láj automobilin me ujë të ftotët.  
Me çka e lani automobilin?  
Unë e láj automobilin me ujë dhe me sapun.  
Me çka i lani duert?  
Unë i láj duert me ujë të nxehët dhe me sapun.  
Me çka i lani rrobet?  
Unë i láj rrobet me ujë dhe me sapun.
5. A keni automobil?  
Po, unë kam automobil.  
Ç'model është automobili juej?  
Automobili im është Ford.  
A e mbani automobilin gjithëmonë pastër?  
Po, unë e mbaj automobilin gjithëmonë pastër.

Si shkon motori i automobilit tuej?

Motori shkon shumë mirë.

A ka automobili nevojë për goma të reja?

Po, automobili ka nevojë për goma të reja.

Kush e përdor më shumë automobilin, ju apo zoja?

Unë e përdor më shumë.

6. Çka bëni të shtunden? A shkoni në kinema, apo rrini në shtëpi?  
 Të shtunden rrij në shtëpi.  
 Po zoja, çka bën?  
 Edhe ajo rri me mue në shtëpi.  
 Po të dielen, çka bëni ju dhe zoja?  
 Të dielen paradreke shkojmë në kishë; mbasdreke rrijmë në shtëpi.  
 Po fëmijët, çka bëjnë të shtunden dhe të dielen?  
 Fëmijët të shtunden rrijnë në shtëpi; të dielen shkojnë në kishë.
7. A jeni nxënës të zellshëm ju të gjithë?  
 Po, na të gjithë jemi nxënës të zellshëm.  
 A i kanë duert të pastra nxënësit e mirë?  
 Po, nxënësit e mirë i kanë duert të pastra.  
 A është klasa jonë e ndytë, apo e pastër?  
 Klasa jonë është gjithëmonë e pastër.  
 A janë librat dhe fjalorët të përdorun?  
 Po, librat dhe fjalorët janë të përdorun.
8. A i nxëni dialogët përmendsh?  
 Po, unë i nxë dialogët përmendsh.  
 Po shokët tuej, a i nxënë dialogët përmendsh?  
 Po, edhe shokët e mij i nxënë dialogët përmendsh.  
 A keni nevojë për një automobil?  
 Po, unë kam nevojë për një automobil.  
 A keni nevojë për të holla?  
 Jo, unë nuk kam nevojë për të holla.  
 Për çka keni nevojë?  
 Unë kam nevojë për shumë gjëna.  
 Për çka kanë nevojë nxënësit?  
 Nxënësit kanë nevojë për libra, fjalorë dhe rradhorë.
9. A është e mundun me nxënë shqip shpejt?  
 Po, me nxënë shqip shpejt është e mundun.  
 A është e mundun me u-lá me ujë të ftofët?  
 Po, është e mundun me u-lá me ujë të ftofët.  
 A doni me shkue ndokund javën që vjen?  
 Po, javën që vjen due me shkue në Nju Jork.  
 Po shoku juej, a do me shkue ndokund sot mbasdreke?  
 Po, shoku im sot mbasdreke do me shkue në kinema.

Shqipnija gjindet në Ballkan dhe është një vend maluer, me male të nalta; mali më i naltë quhet Korab. Natyrisht, ndër male dimni është shumë i ftofët. Shqipnija ka dy dete: detin Adriatik dhe detin Jon. Në bregun e detit klima është shumë e butë. Durrësi dhe Vlona janë dy skele shumë të rëndësishme për Shqipnijnë; Durrësi është një qytet shumë i vjetër. Shqiptarët flasin shqip; shqipja është gjuha më e vjetër në Ballkan.

Monterej është një qytet i vogël, por një nga qytetet më të vjetra të Kalifornisë. Ky qytet ka ndërtesa e dyqane shumë të bukura; ka edhe teatra, kinema e një doganë. Ministrija e mbrojtjes amerikane ka në Monterej një shkollë për gjuhë, ku ushtarët, nënoficerat dhe oficerat nxënë gjuhë të ndryshme, si p.sh. shqip, italisht, gjermanisht, rusisht etj.

Zotni Smithi është nga Pensilvanija, por ka shumë kohë që jeton në Kaliforni. Ai është kapter dhe nxën rusisht; është i martuem dhe ka tre fëmijë: dy shkojnë në shkollë dhe një është shumë i vogël. Kapter Smithi ka një shtëpi në Palo Alto; këtu ai banon në një shtëpi shumë të bukur në Pasifik Grovë; kjo shtëpi gjindet në bregun e detit; ka shumë dhoma dhe mobilje të bukura. Në Pasifik Grovë shtëpitë nuk kushtojnë shumë.

Kur Zotni Korça vjen në shtëpi për darkë, aty nga ora 5, sofrë është e shtruar. Mbi sofrë ka një pjatë, një pirun, një lugë dhe një thikë për çdo njeri. Mbi raftin e pjatave ka një pjatë të madhe me pemë: portokalla, molla, qershí etj.; ka një pjatë me djathë, një tjetër me ullj dhe ca bukë. Kur ha Zotni Korça pi kafe dhe Zoja Korça pi ujë ase qumësht. Mbasdarke Zotni Korça studjon një dy orë; grueja e tij lán pjatat, pastron kuzhinën dhe dhomën e bukës dhe mandej të dy shkojnë në kinema.

---

We are now in the classroom. Our classroom is quite large; it has two large windows and one door. There are many things inside: desks, chairs, hangers, charts, and one blackboard. The students keep books, pencils, erasers, and many other things that they need on the desks. When the bell rings all students are in the classroom waiting for the instructor. When the instructor enters the classroom he greets (them with) "Good morning, gentlemen!" The students answer, "Good morning, sir!" Afterwards, the students and the instructor begin the lesson. After the first period is over they all go out to smoke a cigarette.

Automobili im nuk është gjithëmonë i pastër. Nganjiherë është i ndytë, sidomos mbrendë, megjithëqë e láj çdo të shtunde me ujë e sapun. Nganjiherë e lajmë bashkë me gruen. Automobilin e kam blé sivjet të përdorun; është Ford 1977. Motori nuk është i keq por automobili ka nevojë për goma të reja. Unë e përdor automobilin më shumë se grueja. Ajo rri zakonisht në shtëpi. Nganjiherë, mbasdarke, shkojmë në kinema, por të shumtën e kohës rrijmë në shtëpi me nxënë dialogun përmendsh, me studjue mësimin, pyetjet e ushtrimet tjera.

Kur unë e grueja shkojmë në kinema, fëmijët rrijnë me një vajzë që marrim me pagesë. Kur rrijnë me të nuk qajnë sepse e njofin.



## QUESTIONS - PYETJE

1. Automobili i kujt nuk është gjithëmonë i pastër?
2. Kur është automobili i ndytë, sidomos mbrendë?
3. Ku është i ndytë nganjherë?
4. Me çka e láj unë automobilin çdo të shtunde?
5. Çka láj unë çdo të shtunde me ujë e sapun?
6. Kur e lajmë bashkë me gruen?
7. Çka lajmë nganjherë bashkë me gruen?
8. Kur e kam blé automobilin?
9. Çka kam blé sivjet?
10. Ç'model është automobili?
11. Qysh është motori?
12. Për çka ka nevojë automobili?
13. Kush e përdor automobilin më shumë se grueja?
14. Çka përdor unë më shumë se grueja?
15. Ku rri ajo, zakonisht?
16. Kush rri në shtëpi, zakonisht?
17. Ku shkojmë, nganjherë, mbasdarke, unë e grueja?
18. Kur shkojmë në kinema unë e grueja?
19. Ku rrijmë të shumtën?
20. Pse rrijmë në shtëpi, të shumtën?
21. Çka nxâ unë përmendsh?
22. Qysh e nxâ dialogun?
23. Kush e studjon mësimin, pyetjet e ushtrimet tjera?

24. Çka tjetër studjoj unë?
25. Me kë rrijnë fëmijët kur na shkojmë në kinema?
26. Cilët rrijnë me një vajzë kur na shkojmë në kinema?
27. Pse nuk qajnë fëmijët kur rrijnë me të?
28. Cilët nuk qajnë kur rrijnë me të sepse e njofin?

Translate the following into Albanian:

1. I went to buy a new car last night after dinner.
2. I need pencils and erasers.
3. I do not eat at all in the morning.
4. They cry because they do not want to go to sleep.
5. The weather is beautiful this year.
6. It is impossible to study in the barracks.
7. He comes from the city at five o'clock.
8. Are you from Durrës?
9. When I do not have to study I do not stay home.
10. Did you go anywhere last night?

PJESA E TETË  
FJALORI

LESSON 26  
PART VIII  
VOCABULARY

automobil, -i automobila, -t	(m.)	car
të lumtë	(interj.)	bravo!
gjithëmonë	(adv.)	always
kishë, -a kisha, -t	(f.)	church
me lá (unë láj)	(v.)	to wash
mbasdarke	(adv.)	after dinner
megjithëqë	(conjunction)	although
model, -i modele, -t	(m.)	model
motor, -i motora, -t	(m.)	motor
e mundun	(adj.f.)	possible
ndokund	(adv.)	anywhere, somewhere
i, e, të ndytë të ndyta	(adj.m.f.)	dirty, filthy
nevojë, -a nevoja, -t	(f.)	need, necessity
pagesë, -a pagesa, -t	(f.)	payment, pay
i, e, të pastër të pastra	(adj.m.&f.)	clean, neat, tidy
me pastrue (unë pastroj)	(v.)	to clean
përditë	(adv.)	everyday
me përdorë (unë përdor)	(v.)	to use, handle

i, e, të përdorun të përdoruna	(adj.m.&f.)	used
përmendsh	(adv.)	by heart, by memory, by rote, from memory
me qá (unë qáj)	(v.)	to cry, to weep
sapun, -i sapuna, -t	(m.)	soap
sidomos	(adv.)	especially, in particular, mainly
sivjet	(adv.)	this year
ushtrim, -i ushtrime, -t	(m.)	exercise, training
i, të zellshëm e, të zellshme	(adj.m.&f.)	zealous, industrious

---

NOTES:

Si është e mundun?	How is it possible? How come?
Si duket	as it seems, as it appears
Si shkon?	How is it running? How are you doing?
Me pasë nevojë	to need

